



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:157875

Datë: 19.01.2021

Numri i dokumentit: 01455959

P.nr.1005/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Fitore Daci si dhe me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.M., me vendbanim në rrugën “.....”, Ferizaj, për shkak të veprës penale Prodhimi i ndaluar nga neni 300 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II Nr.1293/2020, të datës 25.11.2020, në praninë e prokurores së shtetit Mimoza Sylja-Hyseni dhe të pandehurit B. M., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 19.01.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. M., i lindur me datë, nga i ati O. dhe e ëma Sh.e, e gjinisë D., me vendbanim në, rruga ”.....”, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Nga muaji qershor i vitit 2020, e deri me datën 03 gusht 2020, pa autorizim në bodrumin e një shtëpie, në rrugën “.....”, në Ferizaj, në kundërshtim me nenin 11 par.1 të ligjit Nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit, është hasur duke bërë përpunimin e duhanit, përpunimi i të

cilit është i kufizuar më ligj, ku nga dogana janë sekuestruar katërmbëdhjetë thasë më duhan të papërpunuar, katër thasë të zinjë me duhan të përpunuar-grirë për shitje, makina për grirjen e duhanit, peshore për matjen e duhanit, paketime për paketimin e duhanit, si dhe makina për mbrehje të brisqeve të makinës grirëse.

me te cilin veprim ka kryer veprën penale Prodhimi i ndaluar nga neni 300 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, dhe 70 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

- **Dënim me gjobë në shumën prej 400 € /katërqind euro/, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit.**
- Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që një /1/ ditë burg do të jetë ekuivalente me njëzetë /20/ euro dënim me gjobë që nuk janë paguar.
- Konform nenit 300 par.2 të KPRK-së mallrat dhe pajisjet për përpunimin e duhanit konfiskohen.
- Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej tridhjetë /30/ ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit.
- Obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me Aktakuzën PP/II nr.1293/2020 të datës 25.11.2020, e ka ngarkuar të pandehurin B.M.për veprën penale Prodhim i ndaluar nga neni 300 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më datë 19.01.2021 në të cilin shqyrtim ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hxseni dhe i pandehuri B. M..

Në fillim të këtij shqyrtimi në mbështetje të nenit 245 par.2 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykyese konstatoi se i pandehuri në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjen e aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj si dhe ka konstatuar se janë plotësuar detyrimet lidhur me zbulimin e provave të parapara në nenin 245 par.4 të KPPK-së.

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 246 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 246 par.4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri B.M.lidhur me të drejtën për tu deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza, se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimin të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq dhe është i penduar thellë për këtë vepër penale, premtion se më nuk do të përsëris vepra të tilla penale dhe kërkon nga gjykata që t'i shqiptoj dënim sa më të butë.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurores së shtetit.

Prokurorja e shtetit Mimoza Sylaj-Hyseni, duke shprehur mendimin e saj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i pandehuri e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-së si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Meqë i pandehuri ka pranuar fajësinë, gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par. 1 të KPPK-së, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: aneksi me nr.000307, në të cilën çekën mallrat të cilat janë gjetur te i pandehuri, si dhe vërtetimi mbi ndaljen dhe konfiskimin e tyre, përmbajtja e dosjes së forenzikës në të cilën përfshihen raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes fotoalbumi nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në dosjen e lëndës.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale prodhimi i ndaluar nga neni 300 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 70 dhe 71 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i pandehuri e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk ka dëshmi se është gjykuar me vendim të formës së prerë,

është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi konfiskimin e përhershëm të mallrave dhe pajisjeve për përpunimin e duhanit është marrë në pajtim me nenin 275 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2, nenpar. 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.1005/20, me datë 19.01.2021

Bashkëpunëtori profesional
Shkelzen Polloviqi

Gjyqtarja
Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.